

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0014-10-2018

Banka ProCredit i fton të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për:

Shërbime të transportit dhe bartjes të aseteve¹

Të interesuarit mund t'i kërkojnë dokumentet për aplikim prej datës **03 Tetor 2018** në e-mail adresën [procurement\[at\]procreditbank-kos.com](mailto:procurement[at]procreditbank-kos.com).

Vërejtje:

- Banka ProCredit është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga data e dorëzimit.
- Kompania ofertuese mund të bashkangjesë edhe dokumenta shtesë dhe sqarime tjera, të cilat mendon se do ta qartësonin më mirë ofertën e tyre.
- Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të ju kompensohet.
- Banka ProCredit ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit për të sjellur sërish ofertat e tyre.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është **16 Tetor 2018** ora **16:00h**.

Oferta në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë **“Ofertë për shërbime të transportit dhe bartje të aseteve”**, duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të Bankës ProCredit (Bulevardi Xhorxh Bush Nr. 26).

ÇDO PYETJE SHITESË RRETH KËSAJ FTESE PËR OFERTË MUND TA ADRESONI NË :

[procurement\[at\]procreditbank-kos.com](mailto:procurement[at]procreditbank-kos.com)

¹ Me transport dhe bartje të aseteve nënkuptohet transporti dhe bartja e aseteve fikse të bankës. Këtu nuk përfshihet transporti i parave apo personave.